Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 723/20
Date/Datum. 14.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Safije Saramati; Kreshnik Spahiu;	06.10.2020	14.10.2020	723/20
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 26.09.2020, OE "PROFESSIONAL ALARM L.L.C."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me numër: 723/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Cimi@ ELECTRONIC SH.P.K."- Skenderaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi, rregullimi dhe montimi i kamerave të sigurisë", LOT 1 me nr. të prokurimit: 635-20-3827-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Pejës.

AK ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 29.968.50 € për Lot 1.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve dhe
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Me datë 12.09.2020 ne kemi dorëzuar te AK-se kërkesën për ri-shqyrtim duke u bazuar ne faktet dhe argumente te bazuar dhe te gjetura ne dokumentacionin e dorëzuar te OE te rekomanduar për kontrate cimi@Electronic SH.P.K fakte te cilat ne i kemi vendosur ne tabelën mëposhtëm. Ajo qe vlen te theksohet është fakti qe AK-se kërkesën tone për rishqyrtim e ka refuzuar si të pa bazuar me arsyetimin se të gjitha pretendimet tona janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara dhe se këtë e ka konstatuar me ekspert të kësaj fushe dhe të cilët i kanë dhënë te drejt komisionit vlerësuese gjë e cila nuk është aspak e saktë pasi qe te gjitha

faktet dhe pikat e ankese janë te argumentuar dhe kjo mund te vërehet shume lehtë. Pastaj një gjë shume me rendësi që duhet theksuar është që AK-se vendimit mbi refuzimin e ankesës tone i ka bashkangjitur edhe një specifikim të një kamere model DS-2CD7A26G0/P-IZ(H)S 2MP duke pretenduara që kamera që ka ofertuar OE Cimi është konform kërkesave dhe i plotëson kriteret duke mos patur parasysh qe te specifikimet teknik te detyrueshme është kërkuar Kamere 4MP Color 24h ndërsa modeli që AK ka pretenduar qe i plotëson kriteret është vetëm 2MP e cila nuk është Color 24 sipas specifikimit teknik te detyrueshme. Ne dokumentacionin qe ka ngarkuar OE Cimi ne platformën e e-prokurimit me emërtimin *10- AUTORIZIM KATALOGA* dhe pastaj pasi te hapet ky follder mund te shihni qe janë dy dokumente për specifikimin teknik me emërtimet si ne vijim *Pozicioni - 1 Kamera 24 H Color.pdf Pozicioni - 2.pdf*, qe te dyja modelet e kamerave nuk janë konform kërkesave te AK-se dhe ne ankesën tone e kemi bazuar ne kamerën ne Pozicionin 1 për te gjeturat tona ndërsa kur AK ka kthyer përgjigje është bazuar ne Pozicionin 2 pra qe është një model tjetër i kamerës po qe janë munduar qe nga dy modelet te bëjnë kombinime ne mënyre që të bëhet si i përgjegjshëm ndërsa gjendja faktike është që asnjeri prej modeleve të ofertuar nga OE cimi nuk i plotësojnë kriteret qe ka vendosur AK ne specifikimit teknike te detyrueshme dhe me njëfarë mënyre i bije sikur ky OE ka ofruar variante për te njëjtin pozicion.

Bazuar ne te gjeturat tona ne Konsiderojmë që AK-së gjegjësisht komisioni për vlerësimin teknik te ofertave ne ketë procedure te prokurimit ka vepruar ne kundërshtim me Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve dhe Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës dhe te njëjtën gjë e ka bere edhe me ne rastin e refuzimi te ankesës tone pasi qe edhe për kundër faktit qe ka rekomanduar për kontrate OE cimi@Electronic SH.P .K site përgjegjshëm i njëjti OE nuk është i përgjegjshëm dhe nuk i plotëson kriteret sipas kërkesave qe ka parashtruar AK-se ne dosjen e tenderit për arsyet si ne vijim:

Specifikimi i kërkuar	Specifikimi i dorëzuar
Pozicioni 1. Është kërkuar Kamera duhet te ketë portin Lan : l0/100/1000 Mbps	Kamera e dorëzuar nga Cimi e ka portin e komunikimit për 10 here me te vogël se sa është kërkuar i cili ka ofruar kamerë me port komunikimi 1 RJ45 l0M/l00M self-adaptive Ethernet port.
Pozicioni 1. Është kërkuar qe kamera te ketë microSD/SDHC/SDXC card me kapacitet (256 GB)	Është ofertuar kamera me micro SD/SDHC/SDXC card me kapacitet (128 GB)
Pozicioni 2. Është kërkuar qe NVR me 64 kanale te ketë Bandwith në dalje minimum 315mbps.	Pozicioni 2. Është ofruar qe NVR me 64 kanale te ketë Bandwith në dalje minimum 256 Mbps
Pozicioni 2. Është kërkuar që NVR me 64 kanale te ketë funksionet për Inteligjencë Artificiale : Face Detection dhe analitik, Face Detection, comparison, Face.search, body search.	Pozicioni 2. Është ofruar model DS-9664NI-18 NVR me 64 kanale i cilin nuk i ka funksionet sipas kërkesës ne DT dhe për ti plotësuar këto kritere është do te duhet te ofertohej NVR i serisë inteligjente i cili ka kosto shume me te lartë.

Mangësitë nga aspekti- Administrativ

Për (LOT 1)

Dëshmia 7 -1. Auto shportë me (KRAN) Minimum 1 cope

Ne FDT është kërkuar që të dëshmohet se pajisja motorike është i regjistruar dhe ka sigurim valid-Kopja e

librezës te pajisjes.
OE i rekomanduar ka ofruar kopje te librezës se mjetit motorik te cilës i ka skaduar regjistrimi para afatit për dorëzimin e tenderëve.
Duke u bazuar ne te gjeturat tona konsiderojmë qe komisioni për vlerësimin e ofertave nuk ka vepruar drejt gjate vlerësimit te ofertave si dhe nuk ka vepruar drejt lidhur me refuzimin e kërkesës tone për ri-shqyrtim pasi qe dy here radhazi ka vlerësuar si te përgjegjshëm OE Cimi @ Electronic edhe për kundër faktit qe i njëjti është i pa përgjegjshëm edhe nga aspekti teknik dhe administrativ pasi qe nuk ka dorëzuar dokumentet dhe pajisjet sipas kërkesave të parashtruara ne dosjen e tenderit konkretisht te specifikimet teknike te detyrueshme dhe ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 dhe nenin 60 te LPP-se .
Kërkojmë nga OSHP te aprovoj ankesën tone si te bazuar dhe tenderin te kthej ne rivlerësim

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar ne OSHP, janë të njëjta me pretendimet e parashtruara në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar në AK.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat

- Për (LOT 1) Kërkesa 5 Autorizim nga prodhuesi ose dileri i kamerave M.A.F ekskluzivisht për ketë projekt Kërkesa 6 Katalogun e Kamerave Nvr dhe HDD.

- Për (LOT 1) Kërkesa 7 Lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve 1. Auto shportë me (KRAN) Minimum 1 copë.

Dëshmia Dokumentare

- Për (LOT 1) Dëshmia 5 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Autorizim nga prodhuesi ose dileri i kamerave M.A.F valide (kopje) Dëshmia 6 Operatori Ekonomik duhet ti posedoj Katalogët Kamerave Nvr dhe HDD dhe duhet ti dorëzoj me ofertën e tij

- Për (LOT 1) Dëshmia 7 Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet ti ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira), të dëshmohen me kopje të librezave, deklaratë doganore apo ndonjë dëshmi tjetër. Të dëshmohet se pajisja motorike është i regjistruar dhe ka sigurim valid-Kopja e librezës të pajisjes.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim: LOT 1 OE: Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K. është në përputhje me te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe ne ketë rast sipas kriterit për dhënie te kontratës (Tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet) shpallet fitues nga komisioni i vlerësimit, sepse ka ofruar çmimin me te lire oferta e këtij OE për LOT 1 është 24,677.75.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Nuk ka

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "PROFESSIONAL ALARM L.L.C."

Përgjigje në Pretendimi Ankimor numër 1 – OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje kur ka vlerësuar se OE i rekomandua për kontratë i plotëson specifikimet teknike për pajisjet e kërkuara.

AK në dosjen e tenderit, përkatësisht formularin për përshkrimin e çmimit, për pozicionin 1.Kamera ndër të tjera ka kërkuar... *Kamera duhet te ketë portin Lan: 10/100/1000Mbps,* si dhe *microSD/SDHC/SDXC card (256 GB).* Në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, tek kushtet për pjesëmarrje për OE ka vendosur kërkesën me numër 6 "*Katalogun e Kamerave Nvr dhe HDD*" dhe për të njëjtën ka kërkuar dëshminë dokumentare "*Operatori Ekonomik duhet ti posedoj Katalogjet Kamerave Nvr dhe HDD dhe duhet ti dorëzoj me ofertën e tij*". Gjithashtu kkërkesën me numër 8 "*Specifikimi teknik i detyrueshëm*" për të cilën ka kërkuar dëshminë dokumentare "*Deklarat e O.E (e nënshkruar dhe e vulosur) mbi pranimin e specifikimeve teknike të detyrueshme të dhëna nga A.K*".

OE i rekomanduar për kontratë së bashku me ofertën ka dorëzuar deklaratën për përmbushjen e specifikimeve teknike të detyrueshme, e vulosur dhe nënshkruar. Po ashtu ka dorëzuar edhe broshurën e produktit DS-2CD2T47G1-L, që sipas emërtimit është ofertuar për pozicononin me numër rendor 1.Kamera. Në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar me datë 12.09.2020, OE ankues ka paraqitur të njëjtin pretendim. Ndërsa AK në

vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, në arsyetimin për këtë pikë e konstaton që ka ndryshim të specifikave të ofertuara me ato të kërkuara që kanë të bëjnë me portin, mirëpo AK e thekson se dallimi është i "vogël" duke e cilësuar si devijim i vogël dhe që lejohet me Nenin 59, paragrafi 4, pika ii.

AK në këtë rast nuk ka vepruar konform Nenit 59 të LPP-së për shkak se paragrafit të cilit i është referuar AK kërkon që çfarëdo devijimi duhet të kuantifikohet dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Gjatë vlerësimit AK nuk ka evidentuar dhe kuantifikuar devijimin. Në rastin konkret dallimi i 10M/100M/1000M me 10M/100M nuk mund të cilësohet devijim minimal, për shkak se behët fjalë për dallim dhjetë herë me të vogël se sa është kërkuar nga AK.

Së dyti, produkti i ofertuar (DS-2CD2T47G1-L) për pozicionin 1.Kamerë nuk përmbush specifikimin për micro SD/SDHC/SDXC pasi që sipas paramasës është kërkuar në kapacitet deri 256, ndërsa sipas broshurës së modelit të ofertuar ky opsion ofrohet deri në 128 GB. Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar gjithashtu broshurë tjetër të një kamere model DS-2CD7A26G0/P-IZ(H)S me emërtim Pozicioni – 2, të cilën AK e ka bashkëngjitë bashkë me vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim. Sipas të dhënave në këtë broshurë, plotësohen dy specifikimet e mësipërme, mirëpo nuk plotësohet kërkesa themelore e paramasës për rezolucionin, ku AK ka kërkuar 4 MP ndërsa, ky model ka rezolucion 2 MP. Pra si përfundim pretendimi ankimor është i bazuar, duke marrë për bazë që sipas broshurave të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë, asnjëri nga 2 modelet e ofertuara (Hikvision DS-2CD2T47G1-L dhe DS-2CD7A26G0/P-IZ(H)S) nuk plotësojnë specifikimet e kërkuara nga AK.

<u>Përgjigje në Pretendimi Ankimor numër 2</u> - OE ankues më tej pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara, bazuar në modelin e ofertuar të NVR.

AK në dosjen e tenderit, përkatësisht formularin për përshkrimin e çmimit, për pozicionin 2. NVR me 64 Kanale ndër të tjera ka kërkuar ..... *Bandwith ne dalje minimum 315mbps.* OE i rekomanduar për kontratë për këtë pozicion ka dorëzuar broshurën e produktit DS-9600NI-I8 SERIES NVR.

Sipas informatave që prezantohen në broshurën e produktit të ofertuar, bandwith në dalje apo Outgoing bandwidth maksimaë është 256 Mbps, ose 200 Mbps (në rastin kur aplikohet RAID konfigurimi). AK në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, nuk ka evidentuar që ka shqyrtuar këtë pretendim. Pra pajisja e ofertuar nuk përmbush specifikimin minimal të kërkuar nga AK, rrjedhimisht pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi Ankimor numër 3 – Në fund OE ankues pretendon së OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbush kushtet për pjesëmarrje, respektivisht kërkesën numër 7 të kapacitetit teknik dhe profesional të kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ka vendosur kërkesën "*7. Lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve 1. Auto shportë me (KRAN) Minimum 1 copë.*" dhe dëshminë dokumentare "*Dëshmia 7 Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet ti ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira), të dëshmohen me kopje të librezave, deklaratë doganore apo ndonjë dëshmi tjetër. Të dëshmohet se pajisja motorike është i regjistruar dhe ka sigurim valid- Kopja e librezës të pajisjes.*"

Në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë për këtë kërkesë janë prezantuar disa dokumente. Është dorëzuar libreza për Mercedes Benz Atego 1828 me numër të targës 02-352-BO me datë të skadimit të regjistrimit 08.08.2020. Gjithashtu është dorëzuar marrëveshja për shfrytëzimin e mjetit, e lidhur në mes të OE të rekomanduar për kontratë dhe "Ariani Company" SH.P.K si dhe certifikata e regjistrimit të biznesit e "Ariani Company" SH.P.K.

Në një folder tjetër janë dorëzuar polisa e sigurimit për automjetin Mercedes Benz 311 CDI, me numër të targës 03-998-FT, e cila është valide deri me datë 29.05.2021. Më tej është dorëzuar edhe marrëveshja e lidhur në mes të OE të rekomanduar për kontratë dhe NTSH "Techno-Service" për shfrytëzimin e automjetit të sipërpërmendur, ku në mes tjerash shënohet se automjeti dëshmi është libreza për "Auto-kran" me numër të targave 03-998-FT. Në fund është dorëzuar edhe certifikata e biznesit e NTSH "Techno-Service" së bashku me polisën e sigurimit dhe librezën për automjetin Mercedes Benz 311 CDI, valide deri me datë 31.01.2020. Pra në mjetin e dytë është prezantuar dëshmi për sigurim valid, mirëpo libreza dëshmon që automjeti nuk ka regjistrim.

Marrë për bazë kërkesën dhe dëshminë dokumentare të kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku është kërkuar që OE të prezantojnë librezën për të vërtetuar validitetin e regjistrimit, OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dy libreza me regjistrim të skaduar. Andaj pretendimi ankimor është i bazuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim, për Lot 1.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Komuna e Pejës
- Panelit Shqyrtues - OSHP
- OE ankues - OE "PROFESSIONAL ALARM L.L.C."- Prishtinë